



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Nr. Prot. 246

Tiranë, më 7 Prill 2021

Drejtuar: Z. Ilirjan Celibashi
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Nga: Znj. Erida Skëndaj
Drejtoreshë Ekzekutive
Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Lënda: Vendimmarrja e Këshillit Bashkiak të Tiranës për përjashtimin e bizneseve nga detyrimi për pagesën e tarifës së zënies së hapësirës publike si dhe shtyrja e pagesës së taksave dhe tarifave vendore krijon premisa për keqpërdorim të burimeve shtetërore dhe pabarazi në garën elektorale

I nderuar Zoti Celibashi,

Qysh në datën 25 mars 2021, siç dihet, ka filluar fushata zgjedhore për zgjedhjet parlamentare të datës 25 prill 2021.

Sipas informacionit në media, kryetari i Bashkisë Tiranë, Z. Erion Veliaj ka deklaruar se *“Këshilli bashkiak i Tiranës ka miratuar vendimin për përjashtimin nga pagesa e detyrimit të tarifës së zënies së hapësirës publike për periudhën prill-shtator 2021, për të gjitha subjektet që ushtrojnë aktivitetin e bar, restoranteve dhe hoteleve të klasifikuara si biznes i vogël. Gjithashtu, u vendos dhe shtyrja e afatit të pagesës së taksave dhe tarifave vendore për të gjitha subjektet, deri më 20 maj 2021”*. Për lajmin e plotë mund t’i referoheni faqes zyrtare të medias ku është publikuar ky lajm, ata.gov.al: *“Veliaj jep lajmin e mirë për bizneset e vogla, falen tarifën për hapësirën publike. Ja kush përfiton.”*¹

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) vlerësoi të arsyeshme t’ju vendos në dijeni për këtë rast duke patur parasysh faktin se ky lehtësim ndodh gjatë fushatës zgjedhore, ndërsa Kryetari i Bashkisë Tiranë është njëkohësisht edhe koordinatori politik për fushatën zgjedhore për kryeqytetin, i ngarkuar nga subjekti zgjedhor, Partia Socialiste e Shqipërisë.

KShH e shikon të nevojshme gjithashtu që lidhur me çështjen e mësipërme të evidentojë faktin se verën e kaluar (2020) në kushtet e pandemisë globale Covid-19, disa lokaleve u është lejuar të ushtronin aktivitetin e tyre edhe në hapësirat publike. Në kuadër të garantimit të një gare të ndershme dhe në pozita të barabarta midis subjekteve zgjedhore, tërheq vëmendjen fakti se përse

¹ <http://ata.gov.al/2021/04/06/veliaj-jep-lajmin-e-mire-per-bizneset-e-vogla-falen-tarifat-per-hapesiren-publike-ja-kush-perfiton/>



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

shfrytëzohet pikërisht momenti i fushatës zgjedhore për të krijuar lehtësira të tilla për bizneset, ndërkohë që ekzistonin mundësitë që këto lehtësira të krijoheshin më herët në kohë.

Sipas nenit 91, pika 4 e Kodit Zgjedhor “*Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore*”.

Sikurse mund të vërehet, formulimi i dispozitës së sipërpërmendur është i gjerë dhe nuk parashikon një listë shteruese të ndalimeve të burimeve shtetërore që sjellin përfitime për kategori të caktuara të popullsisë. Gjithashtu, kjo lehtësi nuk mund të justifikohet as me gjendjen e fatkeqësisë natyrore, sikurse parashikon shprehimisht neni 91, pika 4 e Kodit Zgjedhor, pasi për shkak të situatës së krijuar nga pandemia e Covid-19, më datë 24 mars të këtij viti të kaluar, qeveria shqiptare shpalli gjendjen e fatkeqësisë natyrore, e cila zgjati deri më 23.6.2020.

Në vlerësim të KShH-së, ky vendim i Këshillit Bashkiak, i komunikuar në media nga Kryetari i Bashkisë së Tiranës cenon barazinë e garës elektorale, kur na ndan më pak se një muaj nga data e zgjedhjeve, duke sjellë favorizim të subjektit përkatës zgjedhor (PS). Barazia e garës elektorale cenohet për shkak të përdorimit të burimeve shtetërore që mundëson favorizimin e bizneseve shtetërore si rezultat i vendimmarrjes së Këshillit Bashkiak të komunikuar në media.

Sa më sipër, KQZ është institucioni kompetent për të verifikuar saktësinë e këtij informacioni dhe për të arritur në përfundime më të plota, në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe për të ushtruar përgjegjësitë që i janë ngarkuar sipas këtij Kodi. KQZ është gjithashtu institucioni që garanton një interpretim dhe zbatim rigoroz të Kodit Zgjedhor, duke u bazuar në parimet e njohura dhe standartet ndërkombëtare për zgjedhje të lira dhe të ndershme.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm!

Me konsideratë,

Erida Skëndaj
Drejtoreshë Ekzekutive
Komiteti Shqiptar i Helsinkit

